



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
MINISTRIA E FINANCAVE**

**RAPORTI GJYSMËVJETOR PËR
REALIZIMIN E BUXHETIT TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
SË VERIUT**

JANAR - QERSHOR 2022

Shkup, korrik 2022

PËRMBLEDHJE

- Bruto produkti vendor në tremujorin e parë të vitit 2022 shënoi rritje në bazë reale prej 2.4%, si rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme, në kushtet e rritjes së konsumit dhe rritjes së investimeve bruto;
- Shkalla e papunësisë, sipas Anketës së fuqisë punëtore u zvogëluar në 14.8% në tremujorin e parë të vitit 2022, që paraqet rënie prej 1.2 pikë përqindje në raport me tremujorin e njetë të vitit paraprak;
- Norma e inflacionit në gjysmën e parë të vitit 2022 është 10.0%, si rezultat i rritjes së lartë të çmimeve të importit për shkak të rritjes së produkteve primare në bursat botërore, si dhe rritjes së çmimeve të derivateve të naftës;
- Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit në periudhën janar - qershor u realizuan në vlerë prej 116.426 milionë denarë, që paraqet 48.7% të vlerës së planifikuar për vitin 2022 dhe në raport me gjysmëvjetorin e parë të vitit paraprak u rritën për 14.8%;
- Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit në periudhën janar – qershor të vitit 2022 u realizuan në vlerë prej 126.770 milionë denarë, që është 46.5% të planit vjetor dhe në raport me gjysmëvjetorin e parë të vitit paraprak u rritën për 8.3%;
- Në periudhën janar - qershor të vitit 2022, deficiti i Buxhetit të RMV-së është 10.344 milionë denarë, që paraqet 30.9% të deficitit të planifikuar, përkatësisht 1.3% të BPV-së së projektuar për vitin 2022;
- Borxhi shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut në fund të tremujorit të parë të vitit 2022 shënon 46.81% të BPV-së, ndërsa borxhi publik shënon 54.9% të BPV-së.

PËRMBAJTJA


PËRMBLEDHJE.....	1
1. Tendencat ekonomike ndërkombëtare.....	3
2. Tendencat makroekonomike në vend.....	4
2.1. Aktiviteti ekonomik.....	4
2.2. Tregu i fuqisë punëtore.....	7
2.3. Inflacioni dhe lëvizjet monetare.....	8
2.4. Bilanci i pagesave.....	8
3. Sektori fiskal.....	9
3.1. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	9
3.1.1 Realizimi i Buxhetit themelor.....	12
3.1.2 Realizimi i buxhetit të fondeve.....	14
3.1.3 Realizimi i buxhetit të llogarive vetanake për të ardhura të shfrytëzuesve buxhetorë.....	15
3.1.4 Realizimi i Buxhetit të RMV sipas shfrytëzuesve buxhetorë.....	15
3.2. Menaxhimi me borxhin publik.....	18

1. Tendencat ekonomike ndërkombëtare¹

Ekonomia globale është nën ndikimin e invazionit rus mbi Ukrainën, e cila pasohet me sanksione të shumta kundër Rusisë me qëllim që të ushtrojë presion për parandalimin e aksioneve luftarake. Rënia e parashikimeve për rritjen ekonomike globale është rezultat i pasojave ekonomike të konfliktit ushtarak ruso-ukrainas, përkatësisht përkeqësimit të zinxhirëve globalë tashmë të çrregulluar të furnizimit dhe tregut të energjisë, rritjes së fuqishme të çmimeve të produkteve ushqimore primare dhe produkteve energjetike në tregun ndërkombëtar, rënies së besimit të investitorëve, kushteve rigoroze financiare, etj. Kjo krizë ndodh në një kohë kur ekonomia botërore nuk është rikuperuar ende plotësisht nga pandemia Covid-19. Zhvillime të tilla pritet të ndikojnë negativisht mbi rritjen ekonomike, të shkaktojnë rritje të konsiderueshme të normës së inflacionit, rritje të normave të interesit dhe vështirësi në menaxhimin me borxhin publik, që do të vështirësojnë konsolidimin fiskal.

Në vitin 2022, aktiviteti ekonomik global pritet të rritet prej 3.6%, sipas projeksioneve më të fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ndërsa rritja ekonomike e BE-së është projektuar në 2.9%, pas rritjes prej 5.4% në vitin e kaluar. Gjermania, si vend me ekonominë më të madhe në kuadër të BE-së dhe si partner më i rëndësishëm tregtar është projektuar që të ketë rritje të aktivitetit ekonomik prej 2.1% (Grafiku 1).

Grafiku 1. Rritja ekonomike globale (në %)



Rreziqet lidhur me projeksionet janë në rënie si rezultat i pasigurisë së madhe të zhvillimit të mëtejshëm të konfliktit dhe vendosjes së pakove të reja të sanksioneve kundër Rusisë. Zgjidhja e shpejtë e luftës në Ukrainë do të rriste besimin, do të zvogëlonte presionet e çmimeve dhe do të reduktonte pengesat e furnizimit, por rritja ka mundësi që të vazhdojë të ngadalësohet dhe inflacioni të mbetet më i lartë se sa pritej. Përkeqësimi i luftës mund të reflektohet në thellimin e krizës humanitare, rritjen e numrit të refugjatëve dhe përforcimin e sanksioneve kundër Rusisë, gjë që do të ndikonte negativisht në tregtinë e jashtme, investimet e huaja dhe do të thellonte më tej krizën energjetike. Rritja e normave të interesit në kushte të rritjes së borxhit publik si pasojë e pandemisë pritet të rrisë deficitet buxhetore dhe të vështirësojë procesin e konsolidimit fiskal. Rishfaqja e Covid-19 mund të jetë gjithashtu burim i ndikimit negativ, veçanërisht vendosja e masave kufizuese në Kinë dhe shfaqja e llojeve të reja të virusit mund të jetë rrezik serioz.

¹ Analiza në këtë pjesë bazohet në raportin e Fondit Monetar Ndërkombëtar "Shqyrtimi ekonomik botëror", publikuar në muajin prill të vitit 2022.


2. Tendencat makroekonomike në vend²

2.1. Aktiviteti ekonomik

Në tremujorin e parë të vitit 2022, BPV-ja shënoi rritje vjetore prej 2.4% në bazë reale, si rezultat i arritjeve pozitive në sektorin e shërbimeve, industrisë dhe bujqësisë të cilët kishin kontribut pozitiv në rritjen ekonomike, me ç'rast vazhdoi rikuperimi i mëtejshëm gradual i ekonomisë së brendshme në periudhën e paspandemisë.

Aktiviteti në sektorin e shërbimeve në përgjithësi shënoi rritje prej 4.1% në tremujorin e parë, si rezultat i zhvillimeve të favorshme në këto aktivitete: Tregti, transport dhe hoteleri prej 11.2%, veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike prej 5.9 %, aktivitete financiare dhe sigurime prej 1.9 %, art, argëtim dhe rekreacion prej 1.3%, aktivitete lidhur me pronën e patundshme prej 1.2%, si dhe informacione dhe komunikime prej 0.4%. Rënie kishte në administratën publike, mrojtjen, arsimin dhe shëndetësinë prej 1.1%. Zhvillimet pozitive në aktivitetin e tregtisë, sipas të dhënave me frekuencë të lartë, vijuan edhe në muajin prill dhe maj, me ç'rast rritje të qarkullimit është regjistruar në të gjitha segmentet.

Grafiku 2. Struktura e rritjes ekonomike sipas metodës së prodhimit (kontributi në rritje, p.p.)




Në tremujorin e parë, aktiviteti në sektorin industrial shënoi rritje prej 2.2%. Sipas të dhënave mujore të prodhimit industrial gjatë kësaj periudhe, ku minierat, industria e përpunimit dhe sektori energjetik kishin kontribut pozitiv në industri. Të dhënat me frekuencë të lartë tregojnë për vazhdimin e zhvillimeve pozitive në industri, ku rritja e prodhimit industrial në periudhën janar - maj është 2.9%. Kontribut më të rëndësishëm në rritje kanë prodhimi i automjeteve motorike, prodhimi i veshjeve dhe prodhimi i produkteve të gomës dhe produkteve plastike.

Spektori i ndërtimit shënoi rënie prej 17.2% në tre muajt e parë, që sipas të dhënave me frekuencë të lartë është si rezultat i rënies në segmentin e ndërtimeve të larta, ndërkohë që rritje ka në segmentin e ndërtimeve të ulëta në tremujorin e parë. Bujqësia në këtë periudhë shënoi rritje minimale prej 0.3% pas rënies prej 4.6% në tremujorin paraprak, me ç'rast vazhdojnë zhvillimet e ndryshueshme në këtë sektor.


² Në Raport janë shfrytëzuar të dhënat më të reja në dispozicion. Të dhënat lidhur me BPV-në, papunësinë dhe bilancin e pagesave janë në dispozicion që nga tremujori i parë i vitit 2022.

Grafiku 3. Rritja vjetore e prodhimit industrial (në%)



Analizuar sipas anës së shpenzimeve, rritja e aktivitetit ekonomik është rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme, në kushtet e rritjes së konsumit dhe rritjes së investimeve bruto, ndërkohë që kontributi i eksportit neto është negativ. Investimet bruto shënuan rritje prej 38.6%, të cilat vazhduan rikuperimin e tyre të mëtejshëm. Konsumi shënoi rritje në bazë reale prej 4.0%, në kuadër të të cilit konsumi privat i përkrahur nga rritja e pagave, remitancat dhe aktiviteti solid kreditor u rrit për 4.9%, ndërsa konsumi publik u rrit për 0.5% në bazë reale.

Grafiku 4. Ana e shpenzimeve të rritjes ekonomike (kontributi në rritje, pikë përqindjeje)



Në tremujorin e parë, eksporti i mallrave dhe shërbimeve shënoi rritje prej 11.1% në bazë reale, kryesisht si rezultat i rritjes së eksportit të produkteve kimike, hekurit dhe çelikut dhe karburanteve minerale dhe lubrifikantëve. Importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi rritje më të lartë se eksporti, përkatësisht u rrit për 24.4% në bazë reale, kështu që eksporti neto ka kontribut negativ mbi rritjen ekonomike. Rritja e importit është kryesisht si rezultat i importit të produkteve intermediare (të ndërmjetme), i cili është rritur për 37.9% (Grafiku 4). Respektivisht, në vitin 2021, shkëmbimi i jashtëm tregtar tregoi shenja rikuperimi, pas rënies së tij në vitin 2020 si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga virusi i koronës, për t'u intensifikuar në pesë muajt e parë të vitit 2022, ku eksporti i mallrave shënoi rritje nominale prej 18.8%, ndërsa importi i mallrave prej 29.6%.

Aktiviteti ekonomik në vitin 2022 parashikohet të kthehet në nivelin e para krizës, por me rritje më të ulët se sa ishte projektuar paraprakisht, si rezultat i pasojave ekonomike të konfliktit ushtarak ruso-ukrainas, përkatësisht përkeqësimit të zinxhirëve globalë tashmë të çrregulluar të furnizimit dhe tregut të energjisë, rritjes

së fuqishme të çmimeve të produkteve primare ushqimore dhe energjetike në tregun ndërkombëtar, rënies së besimit të investitorëve etj. Dukuri të tilla pritet të ndikojnë negativisht në kërkesën e jashtme, në kushtet e përkeqësimit të pritshmërive sa i përket rritjes globale dhe ekonomike në BE, si dhe kërkesës së brendshme, përkatësisht investimeve në mjete fikse dhe konsum.

Vendi ynë, me masat e miratuara ekonomike për përballimin e krizës energjetike dhe të çmimeve pritet që të ndikojë në mbrojtjen e standardit jetësor të qytetarëve, si dhe do të ofrojë përkrahje financiare për subjektet afariste, me qëllim të rimëkëmbjes më të shpejtë ekonomike. Në periudhë afatmesme, politika fiskale, përmes ridizajnit të shpenzimeve publike, me theks në përforcimin e ciklit të investimeve publike dhe masave që synojnë arrijtjen e rritjes ekonomike të përshpejtuar, inkluzive dhe të qëndrueshme nëpërmjet Planit për financimin e përshpejtimit të rritjes ekonomike, do të ketë ndikim të rëndësishëm në kërkesën për investime dhe potencialin për rritje ekonomike.

Rritja ekonomike në vitin 2022 projektohet të jetë 3.2%, e nxitur nga kërkesa e brendshme, ndërkohë që eksporti neto pritet të ketë kontribut negativ, që parashikohet të ngushtohet gradualisht, në kushtet e rritjes së eksportit dhe të importit.

Dekompozimi i rritjes ekonomike tregon se investimet do të luajnë rol të rëndësishëm në përkrahjen e aktivitetit ekonomik. Rritja reale e investimeve bruto është projektuar në 5% në vitin 2022, në kushtet e rritjes së pritshme dhe të investimeve publike dhe private. Konsumi, gjithashtu, parashikohet që ta përkrahë rritjen e kërkesës së brendshme. Konsumi privat pritet të shënojë rritje reale prej 3.3%, ndërsa rritja e konsumit publik është projektuar në 1.2%.

Tabela 1. Krahasimi i projeksioneve për rritjen ekonomike dhe inflacionin për vitin 2022 (në%)


	Rritja ekonomike	Inflacioni
Ministria e Financave	3,2	7,2
FMN	3,2	6,9
Banka Botërore	2,7	5,5
Komisioni Evropian	3,0	6,7
BERZH	3,0	/
Fitch Ratings	2,8	6,3
Banka Popullore e RMV	2,9	8,8

Burimi: FMN (World Economic Outlook, prill 2022), Banka Botërore (Western Balkans Regular Economic Report, maj 2022), Komisioni Evropian (European Economic Forecast, maj 2022), BERZH (Regional Economic Prospects, maj 2022) d.), Fitch Ratings (prill 2022), Banka Popullore e RMV (Raporti tremujor, maj 2022).

2.2. Tregu i fuqisë punëtore

Rënia e papunësisë vazhdoi në tremujorin e parë të vitit 2022 sipas Anketës së fuqisë punëtore³, përkatësisht shkalla e papunësisë pësoi rënie në 14.8%, që paraqet rënie prej 1.2 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (grafiku 5).


Grafiku 5. Shkalla e papunësisë (në %)



Shkalla e punësimit në tremujorin e parë 2022 është 47.1% dhe krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit 2021 është e pandryshuar, ndërkohë që popullsia aktive përbën 55.3% të popullatës së aftë për punë të përgjithshme dhe është ulur për 0.7 p.p. krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit 2021.

Gjatë katër muajve të parë të vitit 2022, pagat shënuan rritje mesatare prej 8.4% në bazë nominale, me ç'rast në muajin mars dhe prill rritja u intensifikua si rezultat i rritjes së pagës minimale (Grafiku 6). Në këtë periudhë, rritje e pagës mesatare u has në të gjithë sektorët, me ç'rast më e theksuar është në veprimtarinë e hotelerisë, tregti, shërbime profesionale dhe administrative, art, një pjesë e veprimtarive në sektorin industrial, miniera dhe bujqësi.

Grafik 6. Rritja e pagës mesatare neto (në%)




³ Sipas njoftimit të Entit Shtetëror të Statistikave, gjatë përpunimit të të dhënave për tremujorin e parë të vitit 2022, janë shfrytëzuar distribuimet demografike rajonale sipas gjinisë dhe sipas grupmoshave pesëvjeçare për kalibrimin e popullsisë sipas të dhënave nga Regjistrimi i vitit 2021.

2.3. Inflacioni dhe lëvizjet monetare

Në gjysmën e parë të vitit 2022, norma e inflacionit shënon 10.0%, si rezultat i rritjes së lartë të çmimeve të importit si pasojë e rritjes së produkteve primare në bursat botërore. Rritja e çmimeve në bursat botërore është për shkak të çrregullimeve nga ana e ofertës për shkak të çrregullimeve në zinxhirët e furnizimit të shkaktuara nga pandemia dhe konflikti ushtarak në Ukrainë. Çmimet e energjensave në tregun vendas në gjysmën e parë të vitit 2022 u rritën si rezultat i rritjes administrative të çmimeve të energjisë elektrike për amvisëritë sipas vendimit të KRE. Çmimet e ushqimeve, të cilat kanë kontributin më të madh në rritjen e çmimeve në gjysmën e parë të vitit 2022, janë rritur me 13.9%. Inflacioni bazik në këtë periudhë është 5.4% dhe reflekton edhe efektet transferuese të rritjes së madhe të çmimeve të ushqimeve dhe energjensave.

Grafiku 7. Inflacioni i përgjithshëm dhe bazik (në%)




Si reagim ndaj rritjes së inflacionit dhe pritshmërive inflacioniste në gjysmën e parë të vitit, Banka Popullore miratoi vendim për shtrëngimin e politikës monetare dhe rriti tre herë normën bazë të interesit, pas rritjes në muajin prill dhe maj (përkatësisht për 0.25 pikë përqindjeje), në muajin qershor norma bazë e interesit u rrit për 0.25 p.p. dhe shënon 2.0%. Vendimi për shtrëngimin e politikës monetare bazohet në vlerësimin se presionet mbi çmimet e importit janë më afatgjata dhe më të fuqishme, që krijon efekte të caktuara transmetuese në disa kategori çmimesh dhe ndikon në pritjet inflacioniste.

Gjatë muajit maj të vitit 2022, kreditë e përgjithshme u rritën për 9.9% në bazë vjetore, në kushtet e rritjes së kredive për ndërmarrjet prej 11.4% dhe kredive për amvisëritë prej 8.0%. Potenciali i përgjithshëm i depozitave në muajin maj të vitit 2022 shënoi rritje prej 2.4% në bazë vjetore, analizuar sipas valutës, depozitat në valutën vendase u ulën për 5.8%, ndërsa depozitat në valutën e huaj u rritën për 14.4%. Analiza sipas sektorëve tregon se depozitat e ndërmarrjeve dhe amvisërive janë rritur respektivisht për 0.4% dhe 4.5%.

2.4. Bilanci i pagesave

Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave shënoi deficit prej 392.4 milionë euro në tremujorin e parë të vitit 2022, që në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është zgjeruar për 339.5 milionë euro, kryesisht për shkak të rritjes së deficitit në shkëmbimin me mallra dhe shërbime. Fluksi i investimeve të huaja direkte (IHD) shënon 122.4 milionë euro, i cili kryesisht bazohet në riinvestimin e fitimit dhe në masë më të vogël në formën e kapitalit pronësor dhe instrumenteve të borxhit.

Grafiku 8. Saldo e llogarisë rrjedhëse dhe fluksi i të hyrave të IHD-ve (në milionë euro)




Rezervat devizore arrijnë në rreth 3 miliardë euro në muajin qershor të viti 2022 dhe sigurojnë mbulim të importit të mallrave dhe shërbimeve prej 3.6 muajve të 12 mujorit paraprak, që paraqet nivel adekuat për zhvillimin e politikës monetare.

3. Sektori fiskal

3.1. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, të ardhurat e përgjithshme janë planifikuar në vlerë prej 238.899 milionë denarë, shpenzimet e përgjithshme në vlerë prej 272.428 milionë denarë, respektivisht është planifikuar deficit prej 33.529 milionë denarë (deficiti i Buxhetit themelor prej 26.846 milionë denarë, deficit i fondeve prej 812 milionë denarë dhe deficit i llogarive për të ardhurat vetanake prej 5.871 milionë denarë).

Grafiku 9. Paraqitja skematike e Buxhetit të RMV-së, realizimi (në milionë denarë) dhe shkalla e realizimit (në %) në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2022



Të ardhurat e përgjithshme buxhetore janë realizuar në vlerë prej 116.426 milionë denarë, që paraqet 48.7% të vlerës së planifikuar për vitin 2022, respektivisht rritje prej 14.8% në raport me të ardhurat buxhetore të realizuara në periudhën e njëjtë të vitit 2021 (Tabela 2). Në kuadër të të ardhurave të përgjithshme, në bazë të të ardhurave tatimore dhe kontributeve sociale janë realizuar 106.101 milionë denarë, me të cilat shkalla e realizimit është 50.3% nga vlera e planifikuar për vitin 2022, respektivisht është shënuar rritje prej 15.9% krahasuar me vitin paraprak. Njëkohësisht, janë realizuar të ardhura tatimore në vlerë të përgjithshme prej 69.725 milionë denarë⁴ (përkatësisht realizim prej 51.1% nga vlera e planifikuar për vitin 2022), ndërsa janë realizuar kontribute në vlerë prej 36.376 milionë denarë (rritje vjetore prej 7.9%, përkatësisht 48.9% e vlerës së planifikuar për vitin 2022). Në kuadër të të ardhurave tatimore, rritje haset në gjitha llojet e tatimeve, me ç'rast rritje më të lartë shënojnë të ardhurat nga tatimi mbi fitimin prej 48.6%, mandej detyrimet e importit me rritje të arkëtimit prej 22.1%, TVSH-ja 19.8%, tatimi mbi të ardhurat personale prej 17.0% dhe akcizat prej 9.0%.

Shpenzimet e përgjithshme të Buxhetit të RMV në periudhën janar - qershor 2022 janë realizuar në vlerë prej 126.770 milionë denarë, që paraqet 46.5% të planit vjetor, respektivisht rritje prej 8.3% krahasuar me gjysmëvjetorin e parë të vitit 2021. Përveç kësaj, shpenzimet rrjedhëse u realizuan në vlerë prej 118.238 milionë denarë, përkatësisht 50.5% nga vlera e planifikuar për tërë vitin, që paraqet rritje prej 7.0% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2021. Rritje vërehet edhe tek shpenzimet e interesit prej 21.9%, në shpenzimet për mallra dhe shërbime prej 3.8% dhe në paga dhe kompensime prej 3.5%. Transfertat, të cilat janë kategoria më e madhe e shpenzimeve rrjedhëse, u rritën për 7.2%, të nxitura nga rritja e lartë e subvencioneve dhe transfertave prej 17.8% dhe subvencioneve të TVSH-së prej 11.5%. Në kuadër të transfertave, transfertat sociale u rritën për 7.1%. Shpenzimet kapitale u realizuan në vlerë prej 8.532 milionë denarë dhe janë më të larta për 30.0% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021. Norma e realizimit të shpenzimeve kapitale në gjysmëvjetorin e parë të vitit 22.3%.

⁴ Të përfshira janë të ardhurat e llogarive personale në vlerë prej 874 milionë denarë.

Tabela 2. Realizimi i Buxhetit të RMV-së për periudhën janar - qershor të vitit 2022

	Buxheti 2022	Janar - qershor 2022			janar - qershor 2017-2021	janar - dhjetor 2017 - 2021
	milionë denarë	milionë denarë	shkalla vjetore e rritjes (në %)	shkalla e realizimit	shkalla mesatare e realizimit (në raport me buxhetin fillestar)	
TË HYRA TË PËRGJITHSHME	238.899	116.426	14,8%	48,7%	45,1%	95,8%
Tatime dhe kontribute	210.829	106.101	15,9%	50,3%	46,3%	98,2%
Tatime	134.103	68.851	20,4%	51,3%	45,5%	97,9%
Tatim mbi të ardhurat personale	21.051	10.850	17,0%	51,5%	45,0%	98,1%
Tatim mbi fitimin	12.313	9.033	48,6%	73,4%	50,6%	94,2%
TVSH	62.240	31.879	19,8%	51,2%	45,0%	97,7%
Akciza	28.779	11.954	9,0%	41,5%	42,7%	96,0%
Detyrime të importit	8.983	4.824	22,1%	53,7%	53,1%	113,4%
Të ardhura të tjera tatimore	738	311	2,6%	42,1%	41,7%	95,3%
Kontribute	74.371	36.376	7,9%	48,9%	48,4%	99,8%
Të hyra jotatimore	19.171	7.873	19,5%	41,1%	39,3%	80,6%
Të hyra kapitale	3.330	776	80,0%	23,3%	24,8%	91,3%
Donacione nga jashtë	5.570	1.676	-41,0%	30,1%	35,0%	73,3%
Të ardhura nga hua të arkëtuara	0	0	/	/	6,3%	14,0%
SHPENZIME TË PËRGJITHSHME	272.428	126.770	8,3%	46,5%	46,1%	94,9%
Shpenzime rrjedhëse	234.192	118.238	7,0%	50,5%	49,0%	98,0%
Paga dhe kompensime	32.679	15.746	3,5%	48,2%	48,4%	96,4%
Mallra dhe shërbime	20.656	8.710	3,8%	42,2%	38,0%	82,5%
Transferta	170.785	88.658	7,2%	51,9%	51,6%	100,7%
Transferta sociale	124.497	63.562	7,1%	51,1%	49,7%	99,2%
FSPIMV	74.220	38.739	8,7%	52,2%	50,2%	99,3%
Kompensim financiar për të punësuarit	2.810	780	-9,4%	27,8%	41,2%	100,2%
Ndihma sociale	11.417	6.196	2,8%	54,3%	48,3%	96,6%
Mbrojtja shëndetësore	36.050	17.847	6,0%	49,5%	49,8%	99,8%
Transferta të tjera	43.131	24.161	10,7%	56,0%	57,8%	106,1%
Interesi	10.071	5.124	21,9%	50,9%	32,1%	93,5%
Shpenzime kapitale	38.236	8.532	30,0%	22,3%	23,0%	70,0%
SALDOJA E BUXHETIT	-33.529	-10.344	-34,0%	30,9%	60,7%	83,6%

Burimi: Ministria e Financave

Në periudhën janar - qershor 2022 është realizuar deficit i Buxhetit të RMV prej 10.344 milionë denarë, që paraqet 1.3% të BPV-së së projektuar për vitin 2022, respektivisht 30.9% nga plani vjetor (Tabela 2). Në kuadër të Buxhetit të RMV-së, Buxheti themelor ka realizuar deficit prej 10.162 milionë denarë, fondet kanë realizuar deficit prej 853 milionë denarë, ndërsa llogaritë për të ardhurat vetanake kanë realizuar suficit në vlerë prej 671 milionë denarë.


3.1.1 Realizimi i Buxhetit themelor

Të ardhurat e përgjithshme të Buxhetit themelor në periudhën janar - qershor 2022 janë 72.340 milionë denarë dhe paraqesin 50.4% nga të ardhurat e përgjithshme të parapara për vitin 2022 në vlerë prej 143.545 milionë denarëve.

Arkëtimi i të ardhurave tatimore, që paraqesin zërin më të rëndësishëm në kuadër të të ardhurave të përgjithshme, në këtë periudhë janë 68.169 milionë denarë, gjegjësisht 51.4% nga plani vjetor, ndërsa të ardhurat jotatimore dhe kapitale janë realizuar në vlerë prej 4.171 milionë denarë ose 38.4% në raport me planin për të gjithë vitin.

Struktura e të ardhurave tatimore të realizuara tregon se tatimi mbi vlerën e shtuar ka pjesëmarrje më të madhe me 31.879 milionë denarë ose 46.8% nga të ardhurat e përgjithshme tatimore (Grafiku 10). Më pas vijnë të ardhurat nga akcizat e arkëtuara me 11.272 milionë denarë, tatimi mbi të ardhurat personale 10.850 milionë denarë, tatimi mbi fitimin 9.033 milionë denarë, detyrimet e importit 4.824 milionë denarë dhe të ardhurat e tjera tatimore me 311 milionë denarë.


Grafiku 10. Struktura e të ardhurave tatimore të realizuara, janar - qershor viti 2022



Të gjitha shpenzimet e Buxhetit themelor në periudhën janar - qershor të vitit 2022 janë realizuar në vlerë prej 82.502 milionë denarë ose 48.4% nga mjetet e përgjithshme të parapara me Buxhetin themelor për vitin 2022.


Lidhur me strukturën e shpenzimeve të realizuara në këtë periudhë pjesëmarrje më të madhe kanë shpenzimet në bazë të subvencioneve dhe transfertave me 16.505 milionë denarë. Më pas vijnë transfertat rrjedhëse në mjetet buxhetore me 16.350 milionë denarë, pagat, mëditjet dhe kompensimet me 14.839 milionë denarë, transfertat rrjedhëse në njësitë e qeverisjes lokale (NJVL) me 11.004 milionë denarë, shpenzimet kapitale 6.409 milionë denarë, beneficionet sociale prej 6.088 milionë denarë, shpenzimet për mallra dhe shërbime me 6.082 milionë denarë dhe pagesat e interesit me 5.124 milionë denarë. Grafiku 11 tregon pjesëmarrjen në përqindje në shpenzimet e përgjithshme.

Grafiku 11. Struktura e shpenzimeve të realizuara sipas klasifikimit ekonomik, janar - qershor të vitit 2022



Shkalla e realizimit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është 47.5%. Grafiku 12 paraqet të dhëna të dezagreguara për shpenzimet për mallra dhe shërbime.

Grafiku 12. Shpenzime për mallra dhe shërbime, janar - qershor viti 2022 (në milionë denarë)



Transfertat rrjedhëse në fondet buxhetore në gjysmën e parë të vitit paraqesin 52.5% të planit vjetor. Në kuadër të kësaj kategorie, përkatësisht 82.5% i takon transfertave në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut (Fondi i FSPIM), ndërsa pjesa tjetër i përket transfertave në Fondin e sigurimit shëndetësor dhe Agjencinë e punësimin.

Nga mjetet e përgjithshme të planifikuara për transfertat rrjedhëse në NJVL për vitin 2022, 49.3% u realizuan në gjysmën e parë të vitit. Në kuadër të kësaj kategorie, vlera më e madhe, respektivisht 88.7% është në bazë të bllok granteve dhe atyre të destinuara, ndërsa pjesa tjetër është në bazë të granteve nga TVSH-ja.


Shkalla e realizimit në kategorinë e subvencioneve dhe transfertave në periudhën e shqyrtuar është 63.2%. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve, respektivisht 27.8%, janë paguar në bazë të subvencioneve

bujqësore nga Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, ndërsa 5.264 milionë denarë janë paguar si ndihmë për SHA EMV për ballafaqimin me krizën energjetike.

Beneficionet sociale në periudhën janar - qershor paraqesin 55.3% të planit vjetor.

Shpenzimet kapitale në periudhën e shqyrtuar paraqesin 25.6% të mjeteve të planifikuara për këtë qëllim me Buxhetin themelor për vitin 2022. Grafiku 13 paraqet të dhëna të dezagreguara për shpenzimet kapitale.

Grafiku 13. Shpenzimet kapitale, janar - qershor viti 2022 (në milionë denarë)



Në periudhën e shqyrtuar, pagesa e kryegjësë nga Buxheti themelor në raport me borxhin e përgjithshëm është 4.226 milionë denarë, ndërsa pagesat në bazë të interesit janë 5.124 milionë denarë. Nga fluksi dalës i përgjithshëm në bazë të pagesës së kredive, 1.325 milionë denarë janë për pagesën e kryegjësë për kreditorët jorezidentë, ndërsa 2.901 milionë denarë janë për pagesën e kryegjësë për kreditorët vendas. Për kostot në bazë të interesit për kreditorët vendas janë paguar 1.579 milionë denarë, ndërsa për kreditorët e huaj janë paguar 3.545 milionë denarë.

3.1.2 Realizimi i buxhetit të fondeve

Fondi i SPIMV-së në gjysmën e vitit ka realizuar deficit prej 1.111 milionë denarë. Realizimi i të ardhurave dhe fluksi hyrës, duke përfshirë muajin qershor është 41.722 milionë denarë, që paraqet 50.8% në raport me planin për vitin 2022, ndërsa realizimi i shpenzimeve është 42.833 milionë denarë, përkatësisht 51.5% të planit vjetor. Nga të ardhurat e përgjithshme, 23.691 milionë denarë janë të ardhura në bazë të kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor (48.9% të planit vjetor), 16.260 milionë denarë janë transferata nga Buxheti themelor, 682 milionë denarë janë të ardhura të akcizës, ndërsa pjesa tjetër prej 1.089 milionë denarë janë të ardhura tjera të fondit.

Në pjesën e shpenzimeve të Fondit të SPIMV-së, shpenzimet për pensione janë realizuar në vlerë prej 33.268 milionë denarë apo 51.7% nga të parashikuara për vitin 2022. Pagesa e pensioneve zhvillohet sipas dinamikës së parashikuar për vitin 2022. Transferatat nga Fondi i SPIMV-së në fondet pensionale private janë 5.471 milionë denarë, ndërsa kontributet për sigurim shëndetësor për pensionerët në Fondin për sigurim shëndetësor janë realizuar në vlerë prej 3.842 milionë denarë. Shpenzimet për paga, mallra dhe shërbime dhe kosto të tjera janë realizuar në vlerë prej 217 milionë denarë.

Duke përfshirë muajin qershor të vitit 2022, Fondi për sigurim shëndetësor ka realizuar deficit në vlerë prej 283 milionë denarë, në kushte të të ardhurave të realizuara prej 17.799 milionë denarë, që paraqesin 48.3%

të planit vjetor dhe shpenzime të realizuara prej 18.082 milionë denarë, përkatësisht 49.4% nga të planifikuarat për vitin 2022.

Në periudhën e shqyrtuar, janë realizuar të ardhura nga kontributet për sigurim shëndetësor në vlerë prej 10.284 milionë denarë apo 49.0% të planit vjetor. Kontributet për sigurim shëndetësor të pensionerëve të paguara nga Fondi i SPIMV-së janë 3.842 milionë denarë, ndërsa kontributet për sigurim shëndetësor të paguara nga Agjencia për punësim të RMV-së janë 65 milionë denarë. Transfertat nga Buxheti themelor janë 3.348 milionë denarë, transfertat nga participimi shënojnë 223 milionë denarë, ndërsa pjesa tjetër e të ardhurave janë 37 milionë denarë. Në pjesën e shpenzimeve janë realizuar kosto për mbrojtjen shëndetësore primare prej 15.383 milionë denarë, kostot për pushim mjekësor prej 2.056 milionë denarë, për vegla ndihmëse ortopedike prej 283 milionë denarë dhe për mjekim jashtë vendit prej 125 milionë denarë. Shpenzimet për paga, mallra dhe shërbime, si dhe për shpenzime kapitale janë 235 milionë denarë.

Agjencia për punësim të RMV-së në periudhën janar - qershor të vitit 2022 ka realizuar suficit në vlerë prej 541 milionë denarë, në kushte të të ardhurave të realizuara në vlerë prej 1.608 milionë denarë (44.0% nga të planifikuarat për vitin 2022) dhe shpenzimeve të kryera në vlerë prej 1.067 milionë denarë (29.4% në raport me buxhetin vjetor). Kontributet në bazë të sigurimit në rast të papunësisë paraqesin zërin kryesor të të ardhurave dhe janë realizuar në vlerë prej 1.505 milionë denarë, përkatësisht paraqesin 49.0% të planit vjetor.

Shpenzimet e Agjencisë për punësim në bazë të kompensimit financiar për personat e papunësuar në gjysmën e parë të vitit janë 668 milionë denarë, në bazë të mjeteve për punësim të persoave me invaliditet janë 73 milionë denarë, për masa aktive për punësim janë realizuar 112 milionë denarë, ndërsa për pagesë të kontributeve për sigurim pensional dhe shëndetësor për personat e papunësuar janë shpenzuar 65 milionë denarë. Shpenzimet për paga, mallra dhe shërbime të Agjencisë janë 149 milionë denarë.

3.1.3 Realizimi i buxhetit të llogarive vetanake për të ardhura të shfrytëzuesve buxhetorë

Sipas Buxhetit të RMV-së për vitin 2022 është planifikuar deficit për buxhetet e llogarive vetanake për të ardhura të shfrytëzuesve buxhetorë (të destinuar për aktivitete vetëfinancuese, hua dhe donacione) në vlerë prej 5.871 milionë denarë, ndërsa në periudhën e analizuar është realizuar suficit në vlerë prej 671 milionë denarë.

Duke përfshirë muajin qershor të vitit 2022, të ardhurat e përgjithshme të realizuara të këtyre llogarive shënojnë 6.562 milionë denarë (34.9% të planit për vitin 2022), ndërsa janë realizuar shpenzime në vlerë prej 5.891 milionë denarë (23.9% të buxhetit vjetor). Në kuadër të shpenzimeve, për të ardhura rrjedhëse janë shpenzuar 3.784 milionë denarë apo 32.6% të planit vjetor, ndërsa shpenzime kapitale janë realizuar mjete në vlerë prej 2.107 milionë denarë apo 16.2% të planit vjetor.

3.1.4 Realizimi i Buxhetit të RMV sipas shfrytëzuesve buxhetorë ⁵


Në vazhdim është paraqitur pasqyra lidhur me shpenzimet dhe fluksin hyrës nga Buxheti i RMV-së për shfrytëzuesit më të mëdhenj buxhetorë, buxheti vjetor i të cilëve paraqet 81.9% të buxhetit të përgjithshëm të të gjithë shfrytëzuesve buxhetorë (Grafiku 14).

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në gjysmën e parë të vitit 2022 realizoi 26.639 milionë denarë apo 52.6% nga buxheti i planifikuar për vitin 2022. Përveç kësaj, pjesa më e madhe (68.7%) të shpenzimeve në këtë periudhë janë dedikuar për transfertat rrjedhëse në fondet jashtëbuxhetore, për të cilat janë shpenzuar 18.303 milionë denarë apo 53.9% të mjeteve të dedikuara për vitin 2022. Zëri i dytë më i rëndësishëm i shpenzimeve janë beneficionet sociale, të cilat janë 22.8% në shpenzimet e përgjithshme dhe për këtë dedikim janë realizuar 55.3% (6.085 milionë denarë) nga të planifikuarat për vitin 2022.

⁵ Të dhënat e hollësishme mbi të ardhurat dhe shpenzimet sipas shfrytëzuesve janë paraqitur në tabelat në linkun vijues: <https://finance.gov.mk/izvestai-trezoop/>. Të dhënat janë preliminare dhe të pakonsoliduara dhe përfshijnë fluksin hyrës dhe dalës së mjeteve.

Në periudhën janar - qershor të vitit 2022, përmes ndarjes Ministria e Financave - funksione të shtetit⁶ janë realizuar 12.208 milionë denarë, përkatësisht 41.6% nga të parashikuarat për vitin 2022. Pagesat e interesit (5.045 milionë denarë) janë zëri më i rëndësishëm në shpenzimet e përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor me pjesëmarrje prej 41.3%, dhe janë realizuar 49.4% nga mjetet e planifikuara për vitin 2022. Për pagesën e kryegjësë u realizuan 30.5% nga vlera për tërë vitin, respektivisht 3.485 milionë denarë, ndërsa në shpenzimet e përgjithshme merr pjesë me 28.5%. Zëri i tretë më i rëndësishëm, me pjesëmarrje prej 16.6%, janë shpenzimet kapitale, për të cilat janë shpenzuar 2.027 milionë denarë.

Grafiku 14. Struktura e shpenzimeve dhe flukseve dalëse të realizuara sipas shfrytëzuesve buxhetorë, janar - qershor viti 2022



Ministria e Arsimit dhe Shkencës në periudhën janar - qershor të vitit 2022 realizoi mjete të buxhetit në vlerë prej 13.560 milionë denarë (46.8% nga plani), që është për 18.7% më shumë në krahasim me vitin paraprak. Pjesë më të madhe të shpenzimeve (61.3%) paraqesin transfertat rrjedhëse në NJVL, për të cilat janë shpenzuar 8.309 milionë denarë apo 49.6% të mjeteve të planifikuara. Pagat dhe kompensimet janë zëri i dytë më i rëndësishëm me pjesëmarrje prej 17.0% për të cilat janë shpenzuar 2.309 milionë denarë, përkatësisht 49.3% nga të parashikuarat e përgjithshme.

Në gysmën e parë të vitit 2022 në Ministrinë e Punëve të Brendshme gjithsej janë realizuar 6.231 milionë denarë, që paraqet 52.2% të buxhetit për vitin 2022 dhe është për 13.4% më shumë në raport me vitin paraprak. Zëri buxhetor më i rëndësishëm i shpenzimeve janë pagat dhe kompensimet me pjesëmarrje prej 63.8%, për të cilat janë shpenzuar 3.973 milionë denarë ose 48.4% nga plani. Zëri i dytë më i rëndësishëm janë mallrat dhe shërbimet me pjesëmarrje prej 23.3%, nga të cilat janë realizuar 1.451 milionë denarë, që është 65.9% nga plani vjetor.

Në periudhën janar - qershor të vitit 2022, Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural (APFBZHR) realizoi mjete në vlerë prej 4.048 milionë denarë (65.9% të mjeteve të përgjithshme të realizuara për vitin 2022). Zëri kryesor te ky shfrytëzues buxhetor me pjesëmarrje prej 90.2% në shpenzimet e përgjithshme janë subvencionet dhe transfertat, që janë realizuar në vlerë prej 3.653 milionë denarë, përkatësisht 77.7% nga vlera e planifikuar.

6 Në kuadër të kësaj ndarje janë përfshirë këto aktivitete: servisi në kohë i detyrimeve të shtetit në bazë të huamarrjes vendore dhe të jashtme; pagesa e rregullt e kostove operative të shtetit mbi dokumentacionin e dorëzuar paraprak për pagesë; pjesëmarrja në kapitalin e institucioneve financiare ndërkombëtare; Pagesa e TVSH-së në bazë të investimeve kapitale të financuara nga donacionet, financimit të projekteve nga komponentët individualë të IPA-s, etj.

Ministria e Mbrojtjes në gjysmën e parë të vitit 2022, realizoi mjete buxhetore në vlerë prej 4.523 milionë denarë, që paraqet 33.1 të buxhetit të përgjithshëm për këtë vit dhe janë më të larta për 22.0% në krahasim me vitin paraprak. Pagat dhe kompensimet kanë pjesëmarrje më të madhe të shpenzimeve prej 46.0%, që në periudhën janar - qershor të vitit 2022 u relaizuan 2.078 milionë denarë (47.5% të mjeteve të përgjithshme të parashikuara). Shpenzimet për mallra dhe shërbime përbëjnë 29.2% të shpenzimeve të përgjithshme, për të cilat sa i përket periudhës së analizuar janë shpenzuar 1.319 milionë denarë ose 43.8% të parashikimeve të përgjithshme.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në gjashtë muajt e parë të vitit 2022 realizoi mjete prej 5.710 milionë denarë, që është 58.3% nga plani për këtë vit dhe janë më të larta për 55.5% krahasuar me vitin paraprak. Zëri më i madh me pjesëmarrje prej 73.0% janë subvencionet dhe transfertat, për të cilat në gjysmën e parë të vitit 2022 janë shpenzuar 4.170 milionë denarë, respektisht 57.7% nga sa ishte planifikuar për vitin 2022. Zëri i dytë i rëndësishëm me pjesëmarrje prej 22.6% janë shpenzimet kapitale, për të cilat janë realizuar 1.290 milionë denarë ose 76.1 nga mjetet e planifikuara për vitin 2022.


Ministria e Shëndetësisë në gjysmën e parë të vitit realizoi mjete të buxhetit në vlerë prej 2.343 milionë denarë (rënie prej 33.0% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak), që është 31.1% të buxhetit të përgjithshëm për vitin 2022. Shpenzimet për transfertat rrjedhëse në fondet jashtëbuxhetore kanë pjesëmarrjen më të madhe në shpenzimet e përgjithshme me 48.2%, për të cilat në periudhën janar - qershor 2022 janë shpenzuar 1.129 milionë denarë ose 37.6% nga mjetet e destinuara për vitin 2022. Mallrat dhe shërbimet janë zëri i dytë më i rëndësishëm me pjesëmarrje prej 42.6% në shpenzimet e përgjithshme dhe në periudhën e analizuar për këtë qëllim janë shpenzuar 997 milionë denarë, përkatësisht 31.8% nga të parashikuarat e përgjithshme.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve në periudhën janar - qershor të vitit 2022 realizoi mjete në vlerë prej 1.187 milionë denarë, që paraqet 10.2% të buxhetit të përgjithshëm për vitin 2022 dhe janë për 13.4% më të larta krahasuar me vitin paraprak. Zëri buxhetor me pjesëmarrje më të madhe në shpenzimet e përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor janë shpenzimet kapitale, realizimi i së cilave në gjysmën e parë të vitit 2022 është 620 milionë denarë (52.2% nga shpenzimet e përgjithshme), që është 5.9% të buxhetit të përgjithshëm për këtë qëllim. Për subvencionet dhe transfertat janë shpenzuar 440 milionë denarë, që paraqet 61.6% nga vlera e planifikuar për tërë vitin, ndërsa në shpenzimet e përgjithshme janë 37.0%.

3.2. Menaxhimi me borxhin publik


Borxhi shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut në fund të tremujorit të parë të vitit 2022 është 6.113,4 milionë euro, respektivisht 46.8% e BPV-së së parashikuar për vitin 2022, ndërsa borxhi publik⁷ është 7.170,5 milionë euro, respektivisht 54.9% e BPV -së (grafiku 15). Njëkohësisht, krahasuar me fundin e vitit 2021, pjesëmarrja e borxhit shtetëror në BPV është më e ulët për 5 p.p., ndërsa e borxhit publik për 5.9 p.p.. Të dhënat për nivelin e borxhit implikojnë ristabilizimin e tij, që vjen pas periudhës së rritjes së borxhit, të shkaktuar nga kriza me pandeminë Covid-19.

Grafiku 15. Gjendja e borxhit shtetëror dhe publik (në % të BPV-së)



Sa i përket strukturës së normës së interesit të borxhit shtetëror, në fund të tremujorit të parë të vitit 2022 raporti normës së interesit fikse dhe variabile është përkatësisht 78.8:21.2 (Grafiku 16). Nga aspekti i kompozimit valutor, borxhi në valutën vendase ka pjesëmarrje prej 24.6% në portofolin e borxhit shtetëror të përgjithshëm, ndërsa borxhi i shprehur në valutën vendase ka pjesëmarrje prej 75.4%. Përveç kësaj, pjesëmarrja e borxhit në euro në borxhin e përgjithshëm shtetëror është 69.3% (duke përfshirë edhe letrat shtetërore me vlerë në tregun e brendshëm me klauzolë devisorë), të drejtat speciale për tërheqje kanë pjesëmarrje me 5.6%, borxhi në jen japonez ka pjesëmarrje me 0.45%, ndërsa borxhi i shprehur në dollarë ka pjesëmarrje prej 0.1%

Grafiku 16. Interesi (ana e majtë) dhe struktura valutore e borxhit shtetëror në tremujorin e parë të vitit 2022



⁷ Me ndryshimet në Ligjin për borxhin publik në muajin maj të vitit 2019 ("Gazeta Zyrtare" nr.98/2019), borxhi jo i garantuar u përfshi në përcaktimin e borxhit publik.

Në tregun vendor në periudhën janar - qershor të vitit 2022, Ministria e Financave në bazë të rregullt emetoi letra shtetërore me vlerë, në përputhje me kalendarin për emetimin e LSHV.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2022 u realizuan rishikime të rregullta të vlerësimit të rejtingut kreditor të vendit nga Agjencia e rejtingut kreditor “Fitch” dhe “Standard & Poors”.

- Në muajin prill të vitit 2022, Agjencia e rejtingut kreditor “Fitch” e konfirmoi rejtingun kreditor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke e vlerësuar me “BB +”, me perspektivë negative. Rejtingu i Republikës së Maqedonisë së Veriut bazohet në qeverisjen e mirë, klimën pozitive të biznesit, si dhe politikën makroekonomike dhe financiare të qëndrueshme dhe koherente, konzistente me kursin fiks valutor afatgjatë dhe inflacion rekord të ulët.
- Në muajin shkurt të vitit 2022, Agjencia e rejtingut kreditor “Standard & Poor's” e konfirmoi rejtingun kreditor të vendit me BB- me perspektivë stabile. Pritshmëritë e Agjencisë janë që ekonomia e Maqedonisë të kthehet në rrugën e rritjes ekonomike këtë vit dhe t'i tejkalojë goditjet e krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19.